



Shkruan: Akademik Arsim BAJRAMI



PDK-ja DHE ALEANCA REFUZOJNË TAKIMIN ME HAXHIUN, KËRKOJNË KONSTITUIMIN E KUVENDIT

FAQE 4-5



PDK-ja dhe Aleanca kanë refuzuar takimin e thirrur nga ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, duke thelluar përplasjet politike rreth krizës institucionale. Derisa Haxhiu dhe Lëvizja Vetëvendosje

janë duke kërkuar marrëveshje për presidentin e ardhshëm, PDK-ja dhe Aleanca kanë insistuar në vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit, e cila mbetet e bllokuar. Deputetët e PDK-së dhe Aleancës të dielën ka

shkuar në Kuvend, por e kanë gjetën të mbyllur sallën plenare. PDK-ja ka akuzuar pushtetin për bllokim institucional, ndërsa Aleanca ka kundërshtuar çdo marrëveshje politike pa u konstituar më parë Kuvendi

**DEPUTETI
UKRAINAS
KRITIKON
ZELENSKYN:
UKRAINA DUHET
TA NJOHË
KOSOVËN** F. 5



**PËRPJEKJET
E DËSHTUARA
TË SERBISË
PËR SPIUNAZH
NË KOSOVË** F. 2



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +389 44 487 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
STYROLKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegji biznesi.com
info@kolegji biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



**HAMZA: 30 DITË DERI KUR DO TË
MARRË FUND PROCESI GJASHTËVJEÇAR
NË HAGË, LIDERËT E UÇK-së DUHET
TË KTHEHEN NË SHTËPI** F. 3

**PESE QYTETARË TË KOSOVËS NË
MESIN E TË LËNDUARVE NGA ZJARRI
NË NJË HOTEL NË VLORË** F. 6

**ARRESTOHET IGOR MARKOVIO, I
DYSHUARI PËR SULM NDAJ KFOR-it
DHE POLICISË SË KOSOVËS NË
TRAZIRAT E VITIT 2023** F. 6

EKONOMI



**SHQIPTARËT E KOSOVËS
ZGJEDHIN "SHARR TRAVEL"
PËR PUSHIMET NË SHQIPËRI** F. 8

**DOGANA ZBULON 63 MIJË E
400 EURO TË PADEKLARUARA NË
NJË AUTOBUS NË MERDARE** F. 8

SPORT



**PREZANTOHET EKIPI QË DO TA
PËRFAQËSOJË KOSOVËN NË
LOJËRAT MESDHEHETARE 2026** F. 11

HAMZA: 30 DITË DERI KUR DO TË MARRË FUND PROCESI GJASHTËVJEÇAR NË HAGË, LIDERËT E UÇK-SË DUHET TË KTHEHEN NË SHTËPI

PRISHTINË, 16 GUSHT – Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka reaguuar lidhur me gjykimin në Hagë, 30 ditë para shpalljes së aktgjykimit ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së. Ai ka deklaruar se 30 ditë e ndajnë vendin nga 16 shtatori, ditë kur, sipas tij, do të marrë fund procesi gjashtëvjeçar, të cilin e ka vlerësuar si të padrejtë dhe që ka mbajtur Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin

dhe Rexhep Selimin të izoluar në Hagë. “Sot na ndajnë 30 ditë nga 16 shtatori, dita kur do të marrë fund procesi gjashtëvjeçar i padrejtë, që i ka mbajtur Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin të izoluar në Hagë. Gjashtë vite paraburgim. Gjashtë vite larg familjeve dhe Kosovës. Gjashtë vite përballje me paragjykim, tendenca, narrativa politike, shkelje të të drejtave dhe

padrejtësi të shumta. Pritshmëritë dhe kërkesat tona janë të qarta: drejtësi dhe lirim. Pas gjashtë vitesh, 16 shtatori duhet të jetë dita kur mbyllet ky kapitull i dhimbshëm për lirinë, pavarësinë dhe shtetndërtimin tonë. Duhet të jetë dita kur katër ish-udhëheqësit e UÇK-së kthehen në shtëpi. Presim edhe 30 ditë. Presim drejtësi”, ka shkruar Hamza në rrjetet sociale.



DEPUTETI UKRAINAS KRITIKON ZELENSKYN: UKRAINA DUHET TA NJOHË KOSOVËN

PRISHTINË, 16 GUSHT - Deputeti ukrainas, Oleksiy Goncharenko, ka deklaruar se mbështet fuqishëm njohjen e Kosovës nga Ukraina, duke bërë të ditur se për këtë çështje ka sponsorizuar edhe një projektligj në parlamentin ukrainas.

Në një intervistë për “Kosovapress”, Goncharenko ka komentuar qëndrimin e presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky, i cili gjatë vizitës në Serbi ka deklaruar se qëndrimi i Kievit ndaj Kosovës mbetet i pandryshuar. “Jam përkrahës i fuqishëm i njohjes së Kosovës si shtet të pavarur nga Ukraina. Kam sponsorizuar një projektligj për këtë çështje në parlamentin ukrainas. Fatkeqësisht, presidenti Zelensky ka një qëndrim tjetër. Gjithashtu, situata është mjaft e komplikuar për ne tani, në mes të luftës. Do të ishte më mirë që kjo të bëhej para se të fillonte pushtimi në shkallë të plotë, sepse tani çdo hap që ndërmerr Ukraina vlerësohet edhe nga aspekti se si do të ndikojë në situatën tonë, e cila është shumë e vështirë”, ka deklaruar ai.

Goncharenko ka vlerësuar lart mbështetjen që Kosova dhe qytetarët e saj i kanë dhënë Ukrainës, duke theksuar se dy popujt e kuptojnë njëri-tjetrin për shkak të përvojave tragjike që kanë kaluar.

Ai ka theksuar se është i njëjti kërcënim që përdor Rusia edhe në Ballkanin Perëndimor, duke përdorur grupe marginale



serbe. Sipas tij, Ukraina dhe Kosova duhet të kenë një partneritet serioz. “Patjetër që e dimë se populli i Kosovës e mbështet Ukrainën dhe se refugjatë ukrainas kanë qenë në Kosovë. Në përgjithësi, mendoj se ukrainasit, fatkeqësisht, së bashku me popullin e Kosovës, e kuptojnë më mirë se kushdo tjetër në Evropë tani se çfarë është gjenocidi, sepse populli i Kosovës e ka kaluar këtë, ndërsa ukrainasit po e përjetojnë. Prandaj, ne e kuptojmë shumë mirë njëri-tjetrin. Ky është i njëjti kërcënim që Rusia paraqet ndaj Ukrainës. Është i njëjti kërcënim me të cilin Rusia ndikon në Ballkan dhe dëshiron ta vërë atë në flakë, duke përdorur disa grupe marginale

serbe. Kemi shumë të përbashkëta në historinë tonë, fatkeqësisht në historinë tragjike dhe atë të kohëve të fundit. Mendoj se Ukraina dhe Kosova duhet të kenë një partneritet shumë serioz”, ka deklaruar ai.

Deputeti ukrainas ka theksuar se Ukraina duhet të komunikojë edhe me Serbinë, por ka kritikuar afërsinë e Beogradit me Moskën, duke shprehur shpresën se një ditë Serbia nuk do ta mbështesë më Rusinë. “Ukraina duhet të flasë edhe me Serbinë dhe presidentin serb, të flasim me të gjithë. Ne duhet të flasim me të gjithë. Ukraina duhet të flasë edhe me Serbinë dhe presidentin serb. Por të gjithë e dimë se Serbia është

ndoshta vendi më i afërt me Rusinë në Evropë sot. Mendoj se ky është një gabim i madh i Serbisë, por është zgjedhja e tyre. Shpresoj që një ditë Serbia edhe ta ndryshojë këtë, të heqë dorë nga kjo mendësi imperialiste dhe të kuptojë se duhet të ndërtojë një Serbi të re si shtet, jo një perandori ballkanike. Por e kuptoj se sot, fatkeqësisht, shumë serbë nuk e ndajnë këtë pikëpamje”, ka theksuar ai.

Goncharenko ka komentuar edhe largimin e flamurit të Ukrainës nga hapësira publike në Prishtinë nga kryetari Rama, duke e vlerësuar këtë si një veprim të gabuar. Sipas tij, flamuri ukrainas përfaqëson mbështetjen për popullin e Ukrainës dhe jo për një

president të caktuar. “Mendoj se ishte gabim, sepse ky flamur ishte një sinjal i rëndësishëm i mbështetjes për popullin ukrainas, jo për Zelenskyn personalisht. Sot president i Ukrainës është Zelensky, nesër do të jetë dikush tjetër. Por populli ukrainas po lufton jo vetëm për lirinë tonë, por në realitet po mbron të gjithë Evropën, përfshirë edhe Ballkanin. Prandaj, mendoj se ishte gabim nga ana e kryetarit të Prishtinës që ta bënte këtë. E kuptoj se ai dëshironte të tregonte një reagim ndaj deklaratës së presidentit Zelensky. Por, edhe një herë, nuk bëhet fjalë për presidentin, por për popullin ukrainas”, ka shtuar ai.

Rikujtojmë se presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, pak ditë më parë, gjatë qëndrimit në Beograd, ka deklaruar se qëndrimi i Ukrainës për Kosovën mbetet i pandryshuar, ndërsa ka falënderuar Serbinë për qëndrimin ndaj integritetit territorial të Ukrainës.

“Ne respektojmë integritetin territorial të partnerëve tanë dhe të drejtën ndërkombëtare. Sa i përket Kosovës, qëndrimi ynë mbetet i pandryshuar. Jemi mirënjohës ndaj Serbisë për respektimin e integritetit territorial të Ukrainës, përfshirë Krimenë”, ka deklaruar Zelensky gjatë një konference për medie në Beograd së bashku me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq.

Papa Leoni bën thirrje për t'i dhënë fund dhunës ndaj palestinezëve në Bregun Perëndimor

VATIKAN, 16 GUSHT - Papa Leoni XIV ka bërë të dielën thirrje për t'i dhënë fund akteve të përsëritura të dhunës ndaj popullsisë civile palestineze në Bregun Perëndimor. “Unë përsëris apelin tim për t'i dhënë fund dhunës së vazhdueshme

kundër popullsisë civile palestineze në Bregun Perëndimor”, ka deklaruar ai. Papa Leoni XIV i ka bërë gjithashtu thirrje urgjente bashkësisë ndërkombëtare që të avancojë drejt zgjidhjes me dy shtete, për “një paqe të drejtë

dhe të qëndrueshme”, një skenar në të cilin Izraeli dhe një shtet i pavarur palestinez do të bashkëjetonin në paqe. Dhuna nga kolonët izraelitë ndaj palestinezëve në Bregun Perëndimor është rritur gjatë viteve të fundit. Kolonët

radikalë kanë rrethuar shtëpitë palestineze në fshatin Kusra, në veri të Bregut Perëndimor, për një javë. Shtetet e Bashkuara, aleat i ngushtë i Izraelit, së fundmi i kanë bërë thirrje Izraelit që t'i largojë kolonët nga fshati.



NJË MUAJ PARA AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SPECIALE - DREJTËSIA, HISTORIA DHE MBROJTJA E TË VËRTETËS PËR LUFTËN E UÇK-së



Shkruan: Akademik Arsim BAJRAMI

Edhe një muaj na ndan nga shpallja e aktgjykimit në procesin gjyqësor ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi, të cilët tashmë për rreth gjashtë vjet ndodhen në paraburgim, në pritje të përfundimit të këtij procesi.

Ky është një proces me rëndësi të jashtëzakonshme juridike, politike dhe historike për Kosovën. Për shkak të kohëzgjatjes, rrethanave në të cilat është krijuar Gjykata Speciale dhe mënyrës se si është zhvilluar procesi, ai ka ngjallur debate të shumta në Kosovë dhe në opinionin ndërkombëtar.

Si profesor i së drejtës kushtetuese dhe jurist, besoj se ky proces ka qenë në kundërshtim me standardet më të larta të shtetit të së drejtës, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të parimeve universale të një gjykimi të drejtë. Në veçanti, kohëzgjatja e jashtëzakonshme e paraburgimit, kohëzgjatja e procesit, kufizimet e transparencës publike dhe mënyra e trajtimit të çështjeve të ndryshme procedurale kanë ngritur shqetësime serioze juridike dhe kanë krijuar dilema të rëndësishme lidhur me standardet që duhet të respektohen në një proces

penal të këtij niveli.

Megjithatë, përtej aspektit juridik të procesit, ekziston një çështje shumë më e gjerë që prek drejtpërdrejt kujtesën dhe historinë e Kosovës: si do të interpretohet lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në kujtesën ndërkombëtare dhe në historinë bashkëkohore të Kosovës. Për këtë arsye, duhet të jemi të qartë dhe të vendosur: lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte luftë çlirimtare dhe luftë për lirinë e Kosovës.

UÇK-ja u krijua dhe veprroi në rrethana të një represioni të rëndë politik, policor dhe ushtarak të regjimit të Slobodan Millosheviqit ndaj popullsisë shqiptare të Kosovës. Ajo përfaqësoi reagimin e organizuar të një populli që për dekada ishte përballur me mohimin e të drejtave politike, kombëtare dhe njerëzore dhe me një sistem të thellë represioni.

Lufta e UÇK-së ishte pjesë e procesit historik të çlirimit të Kosovës dhe e përpjekjes së popullit të saj për të realizuar të drejtën për liri, dinjitet dhe vetëvendosje. UÇK-ja nuk e krijoi konfliktin në Kosovë. Konflikti ishte rezultat i politikës represive dhe diskriminuese të regjimit serb ndaj Kosovës.

Kjo është një e vërtetë historike që nuk duhet të relativizohet dhe as të zëvendësohet me

narrativa që e shkëpusin luftën e Kosovës nga konteksti i saj historik. Prandaj, çdo përpjekje për ta rishkruar historinë e Kosovës duke e paraqitur luftën çlirimtare si një projekt kriminal, apo duke e barazuar atë me politikën shtetërore të represionit dhe dhunës së regjimit të Millosheviqit, duhet të kundërshtohet me argumente historike, juridike, politike dhe akademike. Një proces gjyqësor nuk mund ta zëvendësojë historinë.

Historia e Kosovës nuk fillon me një aktakuzë dhe nuk përfundon me një aktgjykim. Historia e luftës së UÇK-së është pjesë e një procesi shumë më të gjerë historik, politik dhe ndërkombëtar që çoi në çlirimin e Kosovës, në ndërhyrjen e NATO-s dhe më pas në krijimin dhe konsolidimin e shtetit të Kosovës.

Prandaj, çfarëdo që të jetë vendimi i Gjykatës Speciale, ai nuk duhet të shndërrohet në instrument për rishkrimin e historisë së Kosovës. Kosova nuk duhet të lejojë që historia e saj të shkruhet nga ata që e kundërshtuan lirinë e saj. Në këtë periudhë të ndjeshme, Kosova ka nevojë më shumë se kurrë për unitet politik dhe kombëtar. Nuk duhet të lejojë që dallimet ndërmjet partive politike dhe debatet e përditshme politike të na ndajnë për çështje që lidhen

me themelet e shtetit tonë.

Mund të kemi pikëpamje të ndryshme për qeveritë, partitë dhe politikën publike. Por përballë përpjekjeve për deformimin e historisë së Kosovës duhet të kemi një qëndrim të përbashkët. Lufta e UÇK-së është pjesë e historisë së përbashkët të Kosovës. Liria e Kosovës është vlerë e përbashkët. Shteti i Kosovës është interes i përbashkët. Prandaj, apeli im është që të gjitha forcat politike, institucionet e Republikës së Kosovës, akademika, intelektualët dhe shoqëria civile të tregojnë unitet, maturi dhe përgjegjësi në mbrojtjen e së vërtetës historike të Kosovës. Nuk duhet të lejojmë që procesi aktual gjyqësor të shndërrohet në burim të përçarjeve të reja politike në Kosovë. Përkundrazi, duhet ta shfrytëzojmë këtë moment për të treguar pjekurinë tonë demokratike dhe institucionale. Duhet të jemi të bashkuar në kërkesën për drejtësi, në respektimin e standardeve ndërkombëtare të gjyqimit të drejtë dhe në mbrojtjen e së vërtetës historike për luftën e Kosovës. Nuk duhet të lejojmë rishkrimin e historisë së Kosovës. Historia duhet të mbështetet në dokumente, në fakte, në dëshmi historike dhe në kontekstin real të ngjarjeve. Kosova duhet të vazhdojë ta

dokumentojë me seriozitet represionin e regjimit serb, dëbimin e popullsisë, shkatërrimin e vendbanimeve, dhunën shtetërore dhe sakrificën e popullit të Kosovës për liri.

Po ashtu, duhet të dokumentohet dhe të studiohet roli historik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në procesin e çlirimit të vendit. Një popull që nuk e dokumenton dhe nuk e mbron historinë e vet, rrezikon që historia e tij të shkruhet nga të tjerët.

Unë dua të besoj se Gjykata Speciale do të japë një vendim të drejtë, të mbështetur në ligj dhe në standardet më të larta të drejtësisë. Shpresoj që vendimi të jetë lirues dhe që ky proces i gjatë të përfundojë me një rezultat që do t'u japë fund shumë prej dilemave dhe akuzave që për vite kanë rënduar mbi Kosovën dhe mbi historinë e saj të luftës çlirimtare. Por, cilido qoftë vendimi, Kosova duhet të mbetet e bashkuar. Sepse pas këtij procesi do të vazhdojë të ekzistojë Kosova, do të vazhdojë të ekzistojë historia e saj, do të vazhdojë të ekzistojë kujtesa e luftës dhe do të vazhdojë përgjegjësia jonë për t'ua përcjellë brezave të ardhshëm të vërtetën mbi rrugën e gjatë që e solli Kosovën deri te liria dhe shteti i pavarur.

PDK-ja DHE ALEANCA REFUZOJNË TAKIMIN ME HAXHIUN, KËRKOJNË KONSTITUIMIN E KUVENDIT

PDK-ja dhe Aleanca kanë refuzuar takimin e thirrur nga ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, duke thelluar përplasjet politike rreth krizës institucionale. Derisa Haxhiu dhe Lëvizja Vetëvendosje janë duke kërkuar marrëveshje për presidentin e ardhshëm, PDK-ja dhe Aleanca kanë insistuar në vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit, e cila mbetet e bllokuar. Deputetët e PDK-së dhe Aleancës të dielën ka shkuar në Kuvend, por e kanë gjetën të mbyllur sallën plenare. PDK-ja ka akuzuar pushtetin për bllokim institucional, ndërsa Aleanca ka kundërshtuar çdo marrëveshje politike pa u konstituar më parë Kuvendi

**EPOKA
ERE****Lirim GECI**

PRISHTINË, 16 GUSHT - Teksa Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca kanë refuzuar ftesën e ushtrueses së detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, për takim me liderët politikë, kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari i Lëvizjes Vetëvendosje, ka bërë thirrje për një marrëveshje politike para vazhimit të punës së Kuvendit. Dehari ka deklaruar se mirëpret ftesat për takime të Haxhiut dhe kryetarit të LV-së, Albin Kurti, dhe u ka bërë thirrje partive politike që të ulen së bashku për të gjetur një zgjidhje për krizën institucionale. Ai ka theksuar se përpjekjet për vazhdimin e seancës pa një marrëveshje politike vetëm sa e tensionojnë më tej situatën dhe rrisin rrezikun e përplasjeve në Kuvend. "Konstituimi i Kuvendit dhe

formimi i Qeverisë pa një marrëveshje paraprake për Presidentin nënkupton zgjedhje të parakohshme, diçka që duhet ta evitojmë", ka shkruar Dehari. Reagimi i tij vjen pasi PDK-ja dhe Aleanca kanë refuzuar ftesën e Haxhiut për takimin e 18 gushtit. PDK-ja ka kërkuar vazhdimin e seancës konstituive, ndërsa Aleanca ka akuzuar Lëvizjen Vetëvendosje se po e zvarrit bllokadën institucionale për ta çuar vendin në zgjedhje. Ndërkohë, LDK-ja ka deklaruar ditë më parë se është e gatshme të votojë për një figurë jopartiake për president dhe se nuk kërkon poste institucionale. Haxhiu u ka dërguar liderëve të partive politike një ftesë për takim konsultativ më 18 gusht, me qëllim të diskutimit për zhvillimet politike dhe institucionale dhe arritjen e një marrëveshjeje për zgjedhjen e një presidenti konsensual.

Ndërsa të dielën Haxhiu, ka shprehur keqardhje që PDK-ja dhe Aleanca kanë refuzuar ftesat për takimin e nesërm (të martën) në orën 9:00. Ajo e ka vlerësuar këtë refuzim si të gabuar dhe të pamatur. Ajo ka theksuar se qytetarët e Kosovës po shprehin vazhdimisht dhe qartë vullnetin e tyre përmes zgjedhjeve, ndërsa është detyrë e udhëheqësve të partive që ta zbatojnë në praktikë këtë vullnet. "Më lejoni të shpreh keqardhjen time të plotë që, pavarësisht ftesës sime të sinqertë, subjektet politike si PDK dhe AAK e refuzuan të njëjtën. Këtë refuzim e konsideroj veprim të gabuar, të pamatur dhe, mbi të gjitha, mungesë të vullnetit për të tejkaluar pozicionimet barrikaduese. Të tilla pozicione nuk e ndihmojnë askënd, aq më pak Republikën tonë. Qytetarët e vendit vazhdimisht po flasin qartë përmes zgjedhjeve,

ndërkaq është detyrë e jona, si përfaqësues të tyre dhe si udhëheqës partish e institucionesh politike, ta zbatojmë atë në praktikë. Kosova ka nevojë për shumë punë. Zgjedhjet do të duhej të ishin opsioni i fundit, nëse jo fare opsion. Mbetem me shpresën që deri të martën të kemi reflektim dhe takimi të jetë sa më i dobishëm drejt gjetjes së një zgjidhjeje", ka shkruar Haxhiu në "Facebook". Ndërkohë, Kurti ka kërkuar që partitë të nisin diskutimet me emra konkretë për presidentin e ardhshëm, me synimin që të shmangen zgjedhjet e reja. Megjithatë, PDK-ja dhe Aleanca janë duke kërkuar që të vazhdojë seanca konstituive e Kuvendit, e cila ka nisur më 6 gusht dhe u ndërpre për shkak të mungesës së një marrëveshjeje politike. Kriza institucionale është krijuar pas zgjedhjeve të 7 qershorit, të cilat janë mbajtur pasi partitë

nuk kishin arritur të gjenin marrëveshje për zgjedhjen e presidentit pas përfundimit të mandatit të Vjosa Osmanit. LV-ja ka fituar 53 ulëse në Kuvend, PDK-ja 22, LDK-ja 18 dhe Aleanca shtatë. Për zgjedhjen e presidentit, Kushtetuta kërkon praninë e të paktën 80 deputetëve në sallë në dy rundet e para të votimit. Nëse presidenti nuk zgjidhet as në rundin e tretë, Kuvendi shpërndahet dhe vendi shkon në zgjedhje të reja.

**Salla e Kuvendit e mbyllur,
Tahiri i PDK-së: Kosova
s'mund të mbahet peng
nga kalkulimet e Kurtit**

Deputetët e PDK-së dhe Aleancës kanë shkuar të dielën në Kuvend, por e kanë gjetur të mbyllur derën e sallës plenare. Shefi i grupit parlamentar të

PDK-së, Arian Tahiri, ka deklaruar se bllokimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk është më vetëm një krizë politike, por çështje e mbrojtjes së rendit kushtetues, institucioneve dhe vetë Republikës. Pas seancës së tretë të iniciuar nga PDK-ja, në përputhje me afatin prej 48 orësh të paraparë me Rregulloren e Kuvendit për vazhdimin e seancës konstitutive, Tahiri ka theksuar se Lëvizja Vetëvendosje po vazhdon të refuzojë thirrjen dhe zhvillimin e seancës, duke e mbajtur Kuvendin të bllokuar dhe institucionet peng të kalkulimeve politike. “Sot nuk po flasim vetëm për një krizë politike. Sot po flasim për Republikën, për Kushtetutën dhe për Kuvendin, për institucione që nuk i përkasin asnjë individi dhe asnjë parti politike”, ka deklaruar Tahiri. Ai ka theksuar se liria dhe shteti i Kosovës janë rezultat i sakrificës së brezave të tërë dhe se askush nuk mund t’i trajtojë institucionet e Republikës si pronë personale apo si instrument për interesa partiake. “Kushtetuta nuk është një dokument që respektohet vetëm atëherë kur i konvenon pushtetit. Kushtetuta është kufiri i pushtetit. Është garancia se institucionet nuk mund të shndërrohen në instrument të një individi dhe se askush nuk është mbi Republikën. As Albin Kurti”, ka deklaruar ai. Tahiri ka vlerësuar se Kosova nuk mund të mbahet peng derisa Albin Kurti t’i zgjidhë problemet dhe kalkulimet e veta politike, duke theksuar se Kuvendi, qeveria dhe institucionet e shtetit nuk janë pronë e asnjë individi. “Vota të jep mandat. Vota nuk të jep pronësi mbi shtetin. Pushteti në demokraci nuk është privilegj personal. Është përgjegjësi, është i kufizuar dhe është i përkohshëm. Mbi të qëndron Kushtetuta”, është shprehur Tahiri. Sipas tij, çdo ditë e humbur në

këtë ngërç institucional është një ditë e humbur për qytetarët e Kosovës, ndërsa përgjegjësia politike nuk mund të fshihet pas procedurave, interpretimeve apo kalkulimeve partiake. “Nuk mund të jesh njëkohësisht pjesë qendrore e bllokadës dhe të paraqitesh si viktimë e saj. Nuk mund t’i bllokosh institucionet dhe pastaj të pyesësh pse institucionet nuk funksionojnë. Nuk mund ta mbash Republikën në pritje dhe pastaj ta quash këtë normalitet demokratik”, ka deklaruar ai. Shefi i grupit parlamentar të PDK-së ka theksuar se kjo betejë nuk bëhet për privilegje apo për pushtet, por për një standard kushtetues që duhet të vlejë njësoj për secilën parti, pavarësisht se kush është në qeverisje dhe kush në opozitë. “Ne nuk kërkojmë privilegj. Nuk kërkojmë përjashtim. Nuk kërkojmë pushtet në tavolinë. Kërkojmë funksionimin e Republikës. Kërkojmë që Kuvendi ta ushtrojë rolin e tij dhe që institucionet të mos mbahen peng i kalkulimeve të një partie”, ka theksuar Tahiri. Ai ka rikujtuar se Republika e Kosovës, e shpallur e pavarur dhe demokratike më 17 shkurt 2008, ka Kushtetutën si aktin më të lartë juridik dhe ka vlerësuar se niveli aktual i shpërfilljes së rendit kushtetues është i papranueshëm. Tahiri ka theksuar se PDK-ja nuk do ta pranojë si normalitet bllokimin institucional dhe as idenë se Kosova duhet të presë derisa një individ të gjejë një zgjidhje politike që i përshtatet atij. “Republika nuk fillon me Albin Kurtin dhe Republika nuk përfundon me Albin Kurtin. Qeveritë ndryshojnë, kryeministrat ndryshojnë, deputetët dhe shumicat ndryshojnë. Republika mbetet”, ka deklaruar Tahiri, duke shtuar se PDK-ja do të vazhdojë të kërkojë rikthimin e menjëhershëm të funksionimit kushtetues të Kuvendit dhe lirin e institucioneve nga kalkulimet politike. “Mbi



deputetin është ligji. Mbi kryeministrin është Kushtetuta. Mbi partinë është institucioni. Mbi pushtetin është Republika. Askush mbi Kushtetutën, askush mbi ligjin, askush mbi institucionet dhe askush mbi Republikën – as sot, as nesër, asnjëherë”, ka deklaruar Tahiri.

Tahiri i Aleancës: Nuk do t’ia lejojmë LV-së pozitën e presidentit pa një pozicion konsensual

Deputeti i Aleancës, Besnik Tahiri, është shprehur i vendosur se nuk do të lejojnë që pozitën e presidentit ta marrë Lëvizja Vetëvendosje. “Presidentin nuk do ta marrë pa pasur një pozicion konsensual, pa marrë parasysh se kush çfarë pozicioni ka, për shkak se ajo është një figurë që duhet të reflektojë unitetin dhe jo partinë. Ne do të punojmë që të pengojmë kthimin e Republikës së Kosovës në parti-shtet”, ka deklaruar Tahiri të dielën, në një prononcim për medie në Kuvend. Më tutje, ai ka theksuar se nuk

mund të ketë marrëveshje politike kur Kuvendi ende nuk është konstituuar. “Qysh mundet me pasur marrëveshje politike kur nuk ka Kuvend të konstituuar? Mbi çfarë logjike mund të arrihet një marrëveshje politike kur neve na është parandaluar hyrja në Kuvend dhe Kuvendi nuk ekziston i konstituuar, mbi çfarë baze?”, është shprehur ai.

Kuvendi sqaron mbylljen e sallës: Nuk morëm njohim zyrtar për seancën e 16 gushtit

Administrata e Kuvendit të Kosovës ka sqaruar se nuk ka marrë njoftim zyrtar për organizimin dhe mbajtjen e një seance plenare më 16 gusht 2026, prandaj nuk janë bërë përgatitjet e nevojshme për zhvillimin e saj. Ky reagim vjen pas raportimeve se deputetët nuk kanë mundur të hyjnë në sallën e seancave plenare. “Për datën 16 gusht 2026, Administratës së Kuvendit nuk i është komunikuar njoftim zyrtar për organizimin dhe mbajtjen e një seance. Për rrjedhojë, nuk

janë ndërmarrë veprimet përkatëse administrative, teknike dhe logjistike për organizimin e një seance të tillë”, është thënë në sqarimin e Kuvendit.

Administrata e Kuvendit ka theksuar se mungesa e njoftimit nuk përbën vendim politik dhe as qëndrim të saj ndaj iniciativave ose pikëpamjeve të deputetëve dhe grupeve parlamentare.

Sipas sqarimit, organizimi dhe shfrytëzimi i sallës plenare bëhet në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, Rregulloren e Kuvendit dhe procedurat përkatëse institucionale. “Administrata ushtron kompetencat e saj në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, duke ofruar mbështetje profesionale dhe të barabartë për të gjithë deputetët”, është thënë në sqarimin e Kuvendit.

Në fund, Administrata e Kuvendit ka bërë me dije se, pas komunikimit zyrtar për mbajtjen e një seance, do t’i ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe do ta sigurojë mbështetjen administrative, teknike dhe logjistike në kuadër të kompetencave të saj.



PESË QYTETARË TË KOSOVËS NË MESIN E TË LËNDUARVE NGA ZJARRI NË NJË HOTEL NË VLORË

VLORË, 16 GUSHT - Gjashtë turistë kanë mbetur të lënduar pasi flakët e zjarrit kanë përfshirë hotelin ku po qëndronin në qytetin e Vlorës, në jug të Shqipërisë. Sipas Policisë, pesë prej të lënduarve janë shtetas kosovarë. Ministria e Shëndetësisë e Shqipërisë ka bërë me dije se njëra prej pacienteve është në gjendje të rënduar, për shkak të përqindjes së lartë të djegieve, dhe po mbahet nën monitorim dhe kujdes të vazhdueshëm mjekësor. Ndërsa në Spitalin e Djegie-Plastikës janë shtruar tri paciente, ndërsa në Spitalin Universitar të Traumës po marrin trajtim dy paciente, të cilat janë paraqitur me dëmtime të shumta. Më herët, shefi i Reanimacionit në Spitalin e

Vlorës, Edmond Breshanaj, ka deklaruar se tre nga gjashtë të lënduarit kanë pësuar djegie të rënda, ndërsa dy të tjerë janë hedhur nga kati i dytë për t'u shpëtuar flakëve dhe kanë pësuar fraktura. Breshanaj ka theksuar se njëra prej pacienteve është djegur pothuajse në 100 për qind të trupit dhe ka rrezikuar jetën, ndërsa një tjetër ka pësuar djegie në rreth 50 për qind të trupit.

Sipas tij, të lënduarit janë të moshës 25 deri në 30 vjeç dhe vijnë nga Prishtina, Lipjani dhe Rrësheni.

Zjarri ka rënë rreth orës 04:00 të mëngjesit të së dielës në hotelin "Brooklyn", në zonën e Lungomares në Vlorë. Policia ka bërë të ditur se zjarri ka qenë aksidental.

"Nga veprimet hetimore të kryera, përfshirë këqyrjen e pamjeve të kamerave të sigurisë, rezultoi se zjarri ka qenë aksidental, i shkaktuar nga djegia e prizës elektrike të frigoriferit, i cili ndodhej në ambientet e restorantit", është thënë në njoftimin e Policisë së Vlorës.

Një prej pushuesve nga Kosova, Luan Salihu, 21 vjeç, nga Lipjani, ka rrëfyer për mediat se ishte në gjumë kur kishte dëgjuar zhurma dhe të bërtitura. Ai ka deklaruar se nuk kishte arritur të dilte nga dera për shkak të tymit dhe ishte hedhur nga ballkoni i katit të dytë, së bashku me bashkëshorten e tij.

Salihu ka treguar se gjatë rënies kishte dëmtuar këmbën dhe po merrte ndihmë mjekësore në



Spitalin e Vlorës.

Një turist nga Polonia ka deklaruar për mediat se ishte hedhur nga dritarja për të shpëtuar nga tymi dhe flakët, por nuk kishte pësuar lëndime.

Pas këqyrjes së pamjeve nga kamerat e sigurisë së hotelit, Policia ka bërë të ditur se, nën drejtimin e Prokurorisë, po vijojnë hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

ARRESTOHET IGOR MARKOVIQ, I DYSHUARI PËR SULM NDAJ KFOR-IT DHE POLICISË SË KOSOVËS NË TRAZIRAT E VITIT 2023

ZVEÇAN, 16 GUSHT - Igor Markoviq është arrestuar të dielën në Zveçan, nën dyshimin se ka sulmuar pjesëtarë të KFOR-it dhe të Policisë së Kosovës gjatë trazirave në veri të vendit, në maj të vitit 2023. Markoviq është arrestuar nga Policia e Kosovës me urdhër të Prokurorisë Speciale. Sipas komunikatës së përbashkët të Prokurorisë dhe Policisë së Kosovës, i dyshuari është arrestuar pas ndërmarrjes së një sërë veprimesh hetimore. Ai dyshohet për veprat penale:



sulm ndaj personit zyrtar; pjesëmarrje në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizëm; bashkim për veprimtari kundërkushtetuese; si dhe rrezikim të personave nën mbrojtje ndërkombëtare. "I.M. është arrestuar në Zveçan, pas ndërmarrjes së shumë veprimeve hetimore. Ai dyshohet për sulm ndaj pjesëtarëve të KFOR-it dhe Policisë së Kosovës në maj të vitit 2023. Prokuroria Speciale dhe Policia e Kosovës do të ndërmarrin veprimet e nevojshme procedurale në

përputhje me ligjin dhe standardet më të larta ndërkombëtare", është thënë në komunikatë.

Si pasojë e sulmeve të grupeve serbe në maj të vitit 2023, janë lënduar 93 ushtarë të KFOR-it, disa prej tyre rëndë, ndërsa disa kanë humbur edhe gjymtyrë. Po ashtu, janë lënduar pesë pjesëtarë të Policisë së Kosovës dhe janë dëmtuar veturat zyrtare të policisë. Gjatë këtyre sulmeve janë lënduar edhe ekupe të mediave dhe janë sulmuar gazetarë.

112 RASTE ME FRUTH NË KOSOVË, GREZDA: MIJËRA FËMIJË JANË VAKSINUAR QË NGA JANARI

PRISHTINË, 16 GUSHT - Në Kosovë, deri më 10 gusht, sipas të dhënave të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, janë evidentuar 112 fëmijë të prekur nga fruthi. Doktoresha e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prishtinë, Florina Grezda, në një intervistë për "EO", ka bërë thirrje që fëmijët të vaksinohen, duke paralajmëruar për rrezikun dhe përhapjen e shpejtë të kësaj sëmundjeje. "Sa i përket rasteve në mbarë Kosovën, është evidentuar numri prej 112 fëmijëve të sëmurë nga sëmundja e fruthit. Normalisht, fëmijët që sëmuren nga fruthi duhet të lajmërohen në Klinikën Infektive dhe të trajtohen nga specialisti infektolog. Është krijuar një panik, kuptohet, te prindërit të cilët nuk i kanë vaksinuar fëmijët, sepse mosvaksinimi me rregull rezultojnë edhe me një shpërthim të një epidemie sa i përket fruthit, pavarësisht edhe sëmundjeve të

tjera, nëse fëmijët nuk vaksinohen me rregull", është shprehur Grezda.

Ajo ka theksuar se fruthi është sëmundje virale dhe shumë e rrezikshme, e cila përhapet shpejt dhe mund të shkaktojë komplikime të rënda. "Sëmundja është shumë e rrezikshme. Është sëmundje virale, domethënë e rëndë. Përhapet shumë shpejt. Do të thotë, një fëmijë i sëmurë, nëse kontakton me 10 fëmijë të tjerë, gjasat që 9 prej tyre të sëmuren janë të mëdha, ndërsa njëri mund të shpëtojë. Mirëpo, normalisht, një vaksinim i mirë e mbron fëmijën. Përhapja është shumë e shpejtë, po tregon edhe fakti i rritjes së numrit të pacientëve prej 16 prillit, prej rasteve të para që janë paraqitur, dhe tashmë në muajin gusht kemi arritur në 112 raste", ka deklaruar ajo.

Sipas Grezdes, fruthi mund të prekë organet vitale dhe të shkaktojë komplikime të ndryshme, përfshirë

pneumoninë, dëmtimin e degjimit, problemet me sytë dhe, në rastet më të rënda, inflamacionin e trurit. Sa i përket vaksinimit, Grezda ka bërë të ditur se nga janari i këtij viti deri më tani, në repartin e vaksinimit janë vaksinuar mijëra fëmijë të grupmoshave të ndryshme. "Po, sipas statistikës që kemi këtu në repartin e vaksinimit, prej janarit të vitit 2026 deri në muajin gusht i kemi të vaksinuar 2500 fëmijë të moshës 1 deri në 5 vjeç. Madje kemi moshën 5 deri në 7 vjeç, domethënë quhet moshë parashkollore, të cilët kanë ardhur këtu para se të regjistroheshin në klasën e parë dhe kanë marrë vaksinën e fruthit. Aty është numri diku 2 890 fëmijë deri më tani të vaksinuar në këtë grupmoshë", ka deklaruar Grezda. Ajo ka shtuar se janë vaksinuar edhe fëmijë që kanë përfunduar klasën e parë gjatë vitit të kaluar shkollor.

Doktoresha ka folur edhe për informacionet që kanë



qarkulluar në rrjetet sociale lidhur me pretendimet për një lidhje mes vaksinës së fruthit dhe autizmit. "Fatkeqësisht, është hapur një lajm në këto grupe shoqërore të prindërve, në rrjetet sociale, duke lidhur problemin e autizmit me vaksinën e fruthit. Është një ko incidencë shumë e rastësishme, sepse vakcina e fruthit jepet mbi moshën 1 vjeç, ndërsa shenjat e para të autizmit që i vëren prindi fillojnë aty, pak para moshës 2-vjeçare. Edhe

është bërë një lidhje ashtu e rastësishme. Studimet shkencore të jashtëzakonshme, të cilat kanë bërë hulumtime te fëmijët me autizëm, nuk kanë gjetur kurrfarë lidhjeje me vaksinën e fruthit", ka deklaruar ajo.

Grezda u ka bërë thirrje prindërve që fëmijët e pavaksinuar t'i dërgojnë në repartet e vaksinimit ose në qendrat më të afërta të mjekësisë familjare.

Ajo ka bërë me dije se institucionet kanë ndërmarrë masa për identifikimin dhe kontaktimin e prindërve të fëmijëve që nuk janë vaksinuar. "Kështu që ne kemi marrë masa. Ne i thërrasim edhe në telefon prindërit, i kemi thirrur, i kemi alarmuar, kemi hyrë në kartotekë, kemi shikuar kujt po i mungon vakcina dhe infermierja është caktuar që çdo ditë të bëjë thirrje dhe t'i ftojë prindërit të vijnë në repartin e vaksinimit. Kanë filluar, por ne presim edhe pak më shumë", ka deklaruar Grezda.

PËRPPJEKJET E DËSHTUARA TË SERBISË PËR SPIUNAZH NË KOSOVË

PRISHTINË, 16 GUSHT - Përballja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk zhvillohet vetëm në diplomaci, në veri të vendit apo në deklaratat politike të liderëve. Një prej fronteve më të rëndësishme, por njëkohësisht më pak të dukshme, është ai i inteligjencës. Aty nuk ka protesta, konferenca për shtyp apo kamera. Ka kontakte të fshehta, burime njerëzore, informacione të mbledhura në terren, identifikim të personave me qasje në të dhëna dhe përpjekje për të ndërtuar rrjete që mund të funksionojnë për një kohë të gjatë pa u zbuluar. Rastet e viteve të fundit tregojnë se ky aktivitet nuk është zhdukur. Përkundrazi, ai vazhdon. Por po ndryshon diçka tjetër. Institucionet e Kosovës po arrijnë gjithnjë e më shpesh ta zbulojnë këtë aktivitet dhe ta çojnë atë deri te institucionet e drejtësisë. Arrestimi i fundit i Fehim Salit, më 13 gusht, është shembulli më i ri dhe ndoshta një prej rasteve më domethënëse për të kuptuar mënyrën se si mund të funksionojë një operacion i tillë. Sali është arrestuar në pikën kufitare në Merdare, në një operacion të përbashkët të AKI-së, Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë Speciale. Gjykata Themelore në Prishtinë më pas i ka caktuar një muaj paraburgim. Ai dyshohet se për një periudhë të gjatë ka bashkëpunuar me BIA-n dhe se ka mbajtur kontakte me një zyrtar të saj, të identifikuar si Zelimir Matović. Por ajo që e bën rastin të veçantë nuk është vetëm dyshimi për përcjellje informacioni. Sipas dosjes së prokurorisë, Sali dyshohet se ka dhënë informacione për situatën politike në Kosovë, ka identifikuar zyrtarë të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe disa prej tyre i ka fotografuar. Po ashtu, Prokuroria pretendon se ai ka dhënë informacione për persona të tjerë dhe se disa prej tyre i ka propozuar si objektiva të mundshëm për kontaktim dhe rekrutim nga BIA. Nëse këto pretendime provohen në gjykatë, atëherë rasti nuk flet vetëm për një person që mbledh informacion për një shërbim të huaj. Ai tregon për një përpjekje shumë më të gjerë, pra identifikimin e objektivave, krijimin e kontakteve dhe zgjerimin potencial të një rrjeti burimesh brenda Kosovës.

Nga “Panda” te rasti Rashković: A po rikthehet modeli i njohur i propagandës së Beogradit?

Një shërbim inteligjent nuk ka nevojë që çdo informacion ta marrë drejtpërdrejt nga institucionet më të larta. Shpesh, ai kërkon njerëz që

kanë qasje në informacione të caktuara, njohje me individë të rëndësishëm ose mundësi për të identifikuar persona të tjerë që mund të rekrutohen. Në rastin e Salit, sipas prokurorisë, dyshohet pikërisht një mekanizëm i tillë. Gjatë bastisjes në shtëpinë e tij janë sekuestruar rreth 39.500 euro, 500 dinarë serbë dhe katër telefona celularë. Prokuroria ka deklaruar gjithashtu se një pjesë e parave lidhen me aktivitetin e dyshuar të spiunazhit. Për më tepër, profili i Salit e bën rastin të rëndësishëm nga pikëpamja e inteligjencës. Ai është mësimdhënës në sistemin arsimor serb në Kosovë dhe më herët ka qenë pjesë e Këshillit Konsultativ për Komunitete pranë Presidencës së Kosovës. Kjo nuk e dëshmon në vetvete ndonjë aktivitet të paligjshëm, por tregon se një person mund të ndërtojë, me kalimin e viteve, një rrjet kontaktesh në fusha të ndryshme të jetës publike dhe institucionale. Dhe këtu rasti i fundit lidhet me një seri rastesh të tjera. Bedri Shabani dhe Muharrem Qerimi janë dy shtetas të Kosovës që po përballen me akuza për spiunazh në favor të BIA-s. Të dy janë deklaruar të pafajshëm dhe procesi ndaj tyre vazhdon, prandaj përgjegjësia penale e tyre nuk mund të konsiderohet e vërtetuar. Por edhe vetë aktakuza ndaj tyre është domethënëse për të kuptuar llojin e informacionit që dyshohet se ka interes për shërbimin serb. Rasti i Shabanit lidhet, sipas akuzës, me informacione për UÇK-në, pjesëtarë dhe eprorë të saj, ndërsa Qerimi, i cili kishte shërbyer më parë në Policinë e Kosovës, akuzohet gjithashtu për spiunazh. Kjo tregon një element të rëndësishëm të luftës së inteligjencës. Informacioni i vlefshëm nuk është vetëm ai që lidhet me atë që po ndodh sot. Për një shërbim inteligjent, edhe informacionet historike, strukturat e sigurisë, ish-pjesëtarët e institucioneve, rrjetet shoqërore dhe njerëzit me qasje në komunitete të caktuara mund të kenë vlerë operative. Në këtë linjë hyn edhe rasti i Fatmir Sheholli, i cili prej vitit 2025 po hetohet nën dyshimet për spiunazh dhe ndaj të cilit është vazhduar masa e paraburgimit. Edhe në këtë rast, duhet bërë dallimi ndërmjet dyshimit dhe fajësisë së provuar me vendim gjyqësor. Pastaj janë rastet që tashmë kanë kaluar në një fazë tjetër, atë të dënimeve gjyqësore. Në prill të këtij viti, Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar me gjashtë vjet burgim Jelena Gjukanoviqin, ish-punonjëse të OSBE-së, për spiunazh në favor të BIA-s. Sipas aktgjykimit, ajo është shpallur fajtoare për



bashkëpunim me shërbimin serb dhe përcjellje të informacioneve sensitive që lidhen me Kosovën. Në një rast tjetër, Hysri Selimi është dënuar me gjashtë vjet burgim për spiunazh në favor të BIA-s. Sipas të dhënave të bëra publike për rastin, informacionet e përcjella kishin të bënin, ndër të tjera, me radikalizimin fetar në Kosovë, ish-pjesëtarë të UÇK-së dhe persona që kishin udhëtuar për t'iu bashkuar organizatës së Shtetit Islamik. Bojan Jevtiq, ish-toger i Policisë së Kosovës, është dënuar me gjashtë vjet burgim dhe 2.000 euro gjobë për spiunazh në favor të Serbisë, si dhe për armëmbajtje pa leje. Ai e kishte pranuar fajësinë. Në një tjetër rast, Aleksandër Vlajiq është dënuar me pesë vjet burgim për spiunazh dhe 1.000 euro gjobë për armëmbajtje pa leje. Edhe ai e kishte pranuar fajësinë për akuzat. Këtu shfaqet një model shumë më interesant sesa një listë emrash. Profilët janë të ndryshme. Informacionet janë të ndryshme. Pozitat e njerëzve janë të ndryshme. Por në disa raste të dënuara dhe në raste të tjera ende nën hetim, emri i BIA-s përsëritet. Kjo nuk është dëshmi se të gjithë këta persona kanë qenë pjesë e një rrjeti të vetëm. Nuk ka prova publike që lejojnë një përfundim të tillë. Por është e mjaftueshme për të ngritur një përfundim tjetër. Interesi i shërbimit serb për të krijuar dhe përdorur burime brenda Kosovës nuk është një fenomen i izoluar. Dhe pikërisht këtu qëndron suksesi më i madh i kundërzbulimit kosovar. Një shërbim inteligjent i huaj mund të ketë burime në një shtet për vite të tëra. Mund t'i përdorë ato për të mbledhur informacione politike, të sigurisë apo sociale. Mund të tentojë të identifikojë njerëz të rinj dhe të zgjerojë rrjetin. Por në momentin kur një prej hallkave zbulohet, rreziku nuk është vetëm humbja e atij

personi. Mund të ekspozohen edhe kontaktet, mënyrat e komunikimit, objektivat, metodat e rekrutimit dhe struktura e operacionit. Prandaj, arrestimi i një agjenti të dyshuar mund të ketë vlerë shumë më të madhe sesa vetë arrestimi. Në rastin e Salit, për shembull, prokuroria pretendon se hetimi ka identifikuar jo vetëm kontaktet e tij me BIA-n, por edhe mënyrën se si ai dyshohet se mbledhte informacion dhe identifikonte persona të tjerë. Katër telefonat e sekuestruar mund të jenë veçanërisht të rëndësishëm për hetimin, pikërisht për shkak të mundësisë që përmbajtja e tyre të ndihmojë në zbardhjen e kontakteve dhe komunikimeve. Kjo e çon luftën kundër spiunazhit në një nivel tjetër.

Nuk mjafton më të pyetet: Kush është spiun?

Pyetja më e rëndësishme është: Kush e ka rekrutuar, për çfarë informacioni është interesuar, me kë ka komunikuar dhe kush tjetër mund të ketë qenë objektiv i të njëjtit operacion? Nëse institucionet e Kosovës arrijnë t'u përgjigjen këtyre pyetjeve, atëherë një operacion i inteligjencës serbe mund të kthehet në një humbje operative për BIA-n. Kjo është edhe arsyeja pse seria e rasteve të fundit duhet parë me një këndvështrim më të gjerë. Kosova nuk mund ta eliminojë spiunazhin. Asnjë shtet demokratik nuk mund ta bëjë këtë. Shërbimet e huaja do të vazhdojnë të kërkojnë informacione dhe burime në vendet që i konsiderojnë strategjikisht të rëndësishme. Por një shtet mund të bëjë diçka tjetër: ta rrisë koston e spiunazhit dhe ta zvogëlojë hapësirën për veprim të shërbimeve të huaja. Rastet e arrestimeve, hetimeve dhe dënimeve tregojnë se Kosova po

ndërton një përvojë të tillë. Në vend që aktiviteti i dyshuar i BIA-s të mbetet në hije, ai po përfundon gjithnjë e më shpesh në dosje hetimore, në gjykata dhe në aktgjykime. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për një shtet relativisht të ri, i cili ndodhet përballë një fqinji që ka struktura të konsoliduara të inteligjencës dhe që e konsideron Kosovën çështje të interesit të drejtpërdrejtë shtetëror. Në këtë përballje, Kosova nuk ka luksin të mbështetet vetëm në reagime gjyqësor. I duhet kundërzbulim profesional, shkëmbim informacioni ndërmjet institucioneve, mbrojtje e burimeve sensitive dhe, mbi të gjitha, prova që mund të qëndrojnë para gjykatës. Rasti i Fehim Salit është një tjetër test në këtë drejtim. Ai nuk është ende një i dënuar për spiunazh dhe çdo pretendim ndaj tij duhet të provohet në procesin gjyqësor. Por mënyra se si rasti është zbuluar, hetuar dhe tashmë është dërguar para gjykatës tregon se institucionet kosovare po përpigën të godasin jo vetëm individin, por edhe mekanizmin përmes të cilit një shërbim i huaj mund të tentojë të mbledhë informacion dhe të krijojë burime të reja. Në fund, kjo është beteja që nuk shihet. Në publik shihen vetëm arrestimet. Por pas tyre qëndron një luftë shumë më e gjatë: survejimi, analiza, identifikimi i kontakteve, verifikimi i dyshimeve dhe ndërtimi i provave. Dhe nëse rastet e fundit janë tregues i një tendence, atëherë mesazhi është i qartë. Serbia mund të vazhdojë të tentojë të krijojë burime në Kosovë, por hapësira për t'i mbajtur ato të padukshme po bëhet gjithnjë e më e ngushtë. Në luftën e inteligjencës, kjo është ndoshta fitorja më e rëndësishme. Jo të pretendosh se nuk ka spiunazh, por të jesh në gjendje ta zbulosh atë para se një rrjet të konsolidohet. /Telegrafi

SHQIPTARËT E KOSOVËS ZGJEDHIN “SHARR TRAVEL” PËR PUSHIMET NË SHQIPËRI

Prishtinë, 16 gusht - Pushimet verore janë një mundësi e mirë për t'u çlodhur, për të eksploruar vende të reja dhe për të shijuar ditët me diell. Mundësitë për pushime janë të shumta, varësisht nga buxheti, preferencat dhe destinacioni. Kompania turistike nga Kosova “Sharr Travel” vazhdon të kujdeset për pushuesit kosovarë, duke ofruar në vazhdimësi oferta për bregdetin shqiptar. Me “Sharr Travel”, udhëtarët mund të udhëtojnë me flotën moderne të autobusëve dhe të rezervojnë pushimet e tyre me oferta

konkurruese. “Sharr Travel” ofron oferta për pushime në hotele me standard të lartë në Durrës, Golem, Shëngjin, Velipojë, Vlorë, Sarandë, Ksamil, si dhe në Ulqin. Vendet janë të limituara, ndërsa kompania u bën thirrje qytetarëve që të shfrytëzojnë ofertat e muajit gusht dhe të bëjnë rezervimet e tyre. Për rezervime dhe informacione, mund të kontaktoni në numrat e telefonit: +383 38 610 015, +383 49 610 015, +383 46 610 015 dhe +383 44 542 029, ose të vizitoni www.sharrtravel.com



“TREPÇA” NIS RIVITALIZIMIN E HORIZONTIT VI NË MINIERËN E ARTANËS



PRISHTINË, 16 GUSHT - Shoqëria aksionare “Trepça” ka deklaruar se, pas rezultateve të arritura gjatë vitit 2026, miniera e Artanës po ndërmerr hapa konkretë për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës minerare. Në fokus është rivitalizimi i Horizontit VI, një projekt i rëndësishëm për krijimin e kushteve për shfrytëzimin e mëtejshëm të rezervave minerare. Deri tani janë pas-truar rreth 918 metra të korridorit kryesor, ndërsa në segmentet e nevojshme janë realizuar punime për përforcimin dhe sigurimin e galerive. “Punimet po vazhdojnë drejt trupit xeheror 1,

me rreth 600 mijë tonë xehe, që sipas vlerësimit aktual paraqet një potencial ekonomik indikativ prej rreth 53.1 milionë eurosh, si dhe drejt oxhaqeve 601 dhe 603, me synim krijimin e lidhjes funksionale të infrastrukturës ekzistuese dhe përgatitjen e kushteve për zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit mineral”, është thënë në njoftimin e “Trepçës”. Sipas “Trepçës”, ky projekt përfaqëson një hap konkret drejt rritjes së kapaciteteve, shfrytëzimit më të mirë të infrastrukturës ekzistuese dhe zgjatjes së perspektivës së punës së minierës së Artanës.

MBI 1.2 MILIONË VIZITORË NË ASETET E TRASHËGIMISË KULTURORE NË SHQIPËRI

TIRANË, 16 GUSHT - Turizmi kulturor në Shqipëri po shënon rritje nga viti në vit. Sipas të dhënave qeveritare, numri i vizitorëve në asetet e trashëgimisë kulturore ka shënuar rritje gjatë periudhës janar-shtator të këtij viti. Sipas shifrave të publikuara nga ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Blendi Gonxhja, gjithsej 1 milion e 259 mijë e 774 vizitorë kanë vizituar asetet e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë nga janari deri në shtator të këtij viti. Ministri Gonxhja nuk i ka kra-

hasuar të dhënat me ato të vitit të kaluar, por me vitin 2023. Sipas tij, bëhet fjalë për një rritje prej 57 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023. “Falë miradmiristrit, të ardhurat nga biletat janë rritur me 84 për qind, krahasuar me vitin 2023”, ka deklaruar Gonxhja. Sipas shifrave të publikuara nga ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Parku Arkeologjik i Butrintit prin me numrin e vizitorëve, me 257 mijë e 670 vizitorë. Pas tij renditet Kalaja e Gjirokastrës me 253 mijë e 407



vizitorë, Parku Arkeologjik i Shkodrës me 150 mijë e 927 vizitorë, Muzeu Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”

me 147 mijë e 178 vizitorë dhe Parku Arkeologjik i Apolonisë me 109 mijë e 669 vizitorë. Turistët e huaj, por edhe ata

vendas, vizitojnë gjatë gjithë vitit qytetet e Shqipërisë që ofrojnë një gamë të gjerë vlerash historike dhe autentike përmes aseteve të trashëgimisë kulturore. Turizmi kulturor është kthyer në një qasje gjithëvjetoje që gjeneron të ardhura të konsiderueshme për ekonominë. Përveç atraksioneve si plazhet, natyra dhe gastronomia, një pjesë e konsiderueshme e turistëve preferojnë të vizitojnë parqet e ndryshme arkeologjike, muzetë kombëtarë, kalatë dhe monumentet e tjera të kulturës.

Dogana zbulon 63 mijë e 400 euro të padeklaruara në një autobus në Merdare

PRISHTINË, 16 GUSHT - Zyrtarët e Doganës së Kosovës kanë zbuluar 63 mijë e 400 euro të padeklaruara gjatë kontrollit të një autobusi në pikën kufitare në Merdare. Dogana e Kosovës ka bërë me

dije se autobusi po qarkullonte në relacionin Gjermani-Kosovë, ndërsa paratë ishin fshehur në bagazhin personal të drejtuesit të autobusit. Mjetet monetare janë ndaluar, ndërsa rasti është iniciuar për trajtim të mëtejshëm

në përputhje me legjislacionin në fuqi. “Dogana e Kosovës rikujton të gjithë udhëtarët se bartja e mjeteve monetare përtej kufirit duhet të deklarohet në përputhje me kërkesat ligjore. Kontrollat e

shtuara do të vazhdojnë me qëllim të parandalimit dhe luftimit të bartjes së paligjshme të parave dhe formave të tjera të kriminalitetit ndërkufitar”, është thënë në njoftimin e doganës.



PSE E NDAJMË POLITIKËN NË TË MAJTË KUNDËR TË DJATHTËS? “FAJËSONI” FRANCËN

Koncepti ynë për politikën si një ndarje mes së majtës e së djathtës lindi në Francën revolucionare. Hartat politike që erdhën më pas ishin më të sofistikuara, por secila prej tyre mbart paragjykimet e veta.

Nga **Frank JACOBS**
- Big Think -

Pse i vendosim politikanët në një spektër nga e majta në të djathtën? Fajin e kanë francezët.

Me 11 shtator 1789, Asambleja Kombëtare e sapokrijuar e Francës votoi nëse mbretit duhej t'i jepej e drejta e vetos mbi ligjet. Nuk ishte një çështje e parëndësishme procedurale. Si një sfidë e drejtpërdrejtë ndaj pushtetit absolut të Luigjit XVI, ai ishte një moment vendimtar i Revolucionit Francez.

Mbrojtësit e monarkisë, që ishin pro vetos, u mblodhën në të djathtë të kryetarit të seancës. Radikalët, të cilët donin t'i kufizonin pushtetin mbretit, u vendosën në të majtë të tij. Pikërisht nga ai renditje historike e ulëseve, në një mbledhje të zhvilluar më shumë se dy shekuj më parë, lindi ndarja më e njohur në politikën demokratike: e majta kundër së djathtës.

La gauche, e majta, u bë sinonim i forcave revolucionare që kërkonin të shfuqizonin privilegjet dhe t'u jepnin më shumë pushtet qytetarëve të zakonshëm. La droite, e djathta, përfaqësonte kundërrevolucionarët, konservatorët që përpiqeshin të mbanin në këmbë rendin e vjetër, i cili po shembej.

Brenda një viti, termat ishin bërë pjesë e zakonshme e fjalorisht politik në Francë. Gjatë shekullit pasues, "e majta" dhe "e djathta" u përhapën në diskutimet politike në mbarë botën. Kjo mënyrë e thjeshtë për të përshkruar bindjet politike përdoret ende sot. Megjithatë, me kalimin e kohës, ky model ka filluar të tregojë kufizimet e tij. Madje, ai kishte mangësi që në momentin e krijimit.

Një dhuratë propagandistike që vazhdon edhe sot

Një nga problemet qëndronte te vetë gjuha. Në frëngjisht, fjala gauche do të thotë edhe i ngathët ose i pakëndshëm. Ndërsa droit, ashtu si fjala angleze right, nuk do të thotë vetëm "djathtas", por edhe "i drejtë".

Ky paragjykim gjuhësor është shumë më i vjetër se Revolucion i Francez, madje edhe se vetë gjuha frënge. Në latinisht, fjala për "të majtën"



është sinister, prej nga rrjedh kuptimi i diçkaje ogurzezë ose keqdashëse. Ndërsa "e djathta" është dexter, prej së cilës vjen fjala "shkathhtësi", që ka kuptim pozitiv. Edhe në Bibël, Jezusi qëndron në të djathtën e Zotit, jo në të majtën e Tij.

Nuk duhet shumë imagjinatë për ta lidhur këtë paragjykim, i pranishëm në dhjetëra gjuhë dhe kultura, me faktin që shumica e njerëzve janë djathtakë. Vetëm rreth 10% e popullsisë përdor dorën e majtë si dorë kryesore. Për pasardhësit politikë të mbështetësve të monarkisë, të qenit "në të djathtë" ka qenë një avantazh propagandistik që vazhdon edhe sot. Ndërsa ata që identifikohen me të majtën duhet të përballen vazhdimisht me lidhjet negative që fjala "e majtë" ka pasur historikisht.

Komunistët, nazistët dhe teoria e patkoit

Por problemi nuk qëndron vetëm te terminologjia. Në vitin 1972, politologu francez Jean-Pierre Faye krijoi termin "patkoi politik", pasi kishte studiuar Gjermaninë e Republikës së Vajmarit. Duke vënë re se komunistët dhe nazistët bashkëpunuan shpesh në fillim të viteve 1930 për të dobësuar qendrën liberale gjermane, Faye propozoi se sa më larg të lëvizësh nga qendra politike, aq më shumë skajet e spektrit

afrohen me njëri-tjetrin. Pra, spektri politik nuk është një vijë e drejtë, por përkulet si një patkua.

Qoftë në formë vije apo patkoi, ndarja majtas-djathtas dominoi pjesën më të madhe të shekullit XX, i cili mund të përmbledhet, në mënyrë të thjeshtuar, kështu: kapitalizmi i kombinuar me demokracinë mundi fillimisht fashizmin në të djathtë dhe më pas komunizmin në të majtë.

Por këto ndarje nuk përshkruajnë më me saktësi politikën e shekullit XXI. Dikush mund të ketë bindje fort të majta për disa çështje dhe fort të djathta për të tjera. Kjo krijon aleanca të pazakonta politike dhe ndryshime të papritura në mënyrën e votimit. Modeli tradicional nuk arrin të shpjegojë pse shumë mbështetës të Bernie Sanders në vitin 2016 votuan më pas për Donald Trump. Por këta votues nuk ishin të hutuar apo irracionalë. Ata po reagonin ndaj diçkaje që modeli klasik nuk e kap dot: një mosbesim të thellë ndaj establishmentit, qoftë të majtë apo të djathtë, dhe një dëshirë po aq të fortë për ta përmbysur të gjithë sistemin.

Liria ekonomike dhe liria personale

Për t'i kuptuar më mirë këto zhvillime, politika duhet parë jo si një vijë me një dimension,

por si një fushë me dy dimensione, pra, si një hartë. Një nga modelet më me ndikim është Grafiku Nolan, i publikuar në vitin 1971 nga David Nolan, themeluesi i Partisë Libertare të Shteteve të Bashkuara.

Nolan argumentonte se çdo ideologji duhet të vlerësohet sipas dy dimensioneve të veçanta: sa kontroll i jep shtetit mbi vendimet ekonomike të qytetarëve dhe sa kontroll i jep mbi jetën e tyre personale. Sipas tij, spektri tradicional majtas-djathtas i bashkon gabimisht këto dy çështje të ndryshme në një të vetme. Duke vendosur lirinë ekonomike dhe lirinë personale në dy boshte të ndara, Grafiku Nolan krijon katër kuadrante, ku, jo rastësisht, libertarizmi ndodhet në pjesën e sipërme. Edhe pse kjo mund të shihet si një zgjedhje në favor të ideologjisë së autorit, ideja themelore mbetet e vlefshme.

Pse e ndajmë politikën në të majtë kundër të

Grafiku politik i David Nolan, duke përdorur dy akse për t'i dhënë spektrit politik një dimension shtesë, dhe katër ekstreme në vend të dy. (Djathtas) Nolan në vitin 1996. Shoqëritë mund të jenë socialiste dhe të lira (si demokracitë sociale nordike), socialiste dhe jo të lira (si Bashkimi Sovjetik), kapitaliste

dhe të lira (si Singapori ose Zvicra), apo kapitaliste dhe jo të lira (si Kili nën Augusto Pinoçet). Këto katër kombinime janë pothuajse të pamundura të dallohen në një vijë të thjeshtë majtas-djathtas. Grafiku ofron gjithashtu një vend të qartë për libertarizmin, një traditë politike tipike e botës anglishtfolëse, e cila nuk klasifikohet lehtësisht as si e majtë dhe as si e djathtë, duke mbetur praktikisht "pa shtëpi" në spektrin tradicional francez. Ai ndihmon gjithashtu të kuptohet më mirë se ku pozicionohen lëvizjet moderne autoritare: në pjesën e poshtme të grafikut, në të dyja anët e boshtit vertikal. Kjo shpjegon deri diku pse etiketat tradicionale "e majtë" dhe "e djathtë" duken gjithnjë e më të pamjaftueshme për të përshkruar politikën e ditëve tona.


George Orwell do të ishte dakord

Diagrami politik në formë diamanti i paraqitur më poshtë, i frymëzuar qartësisht nga Grafiku Nolan dhe që qarkullon në internet që rreth vitit 2000, e përditëson modelin e tij me një orientim tjetër dhe një gamë më të pasur të ideologjive politike. Boshtet vazhdojnë të përfaqësojnë të njëjtat shkallë matëse, por tani skajet janë emërtuar marksizëm dhe liberalizëm (në boshtin

horizontal ekonomik), si dhe anarkizëm dhe fashizëm (në boshtin vertikal të autoritetit shtetëror). Secila nga katër anët e diamantit mban emrin e tiparit që bashkon dy skajet përkatëse: Marksizmi dhe anarkizmi mund të quhen të dy "socialistë", disa forma të marksizmit dhe fashizmit mund të konsiderohen "etatistë", e kështu me radhë. Në disa raste, ky diagram është vërtet ndriçues. Ai pasqyron idenë se anarko-komunizmi dhe stalinizmi ndodhen të dy në anën socialiste të diamantit, por në skaje krejt të kundërta sa i përket rolit të shtetit, një dallim që modeli klasik majtas-djathtas nuk mund ta bëjë.

Pse e ndajmë politikën në të majtë kundër të

George Orwell do të ishte dakord me këtë. Gjatë Luftës Civile Spanjolle, ai luftoi në radhët e një milicie me prirje anarkiste kundër komunistëve besnikë ndaj Moskës. Diagrami gjithashtu e dallon në mënyrë të dobishme libertarizmin nga konservatorizmi, duke ndarë dy rryma të së djathtës amerikane që shpesh ngatërrohen me njëra-tjetrën, por që në thelb janë shumë të ndryshme. Megjithatë, edhe ky model mbështetet mbi disa thjeshtësime të pasakta. Ai vendos anarko-kolektivizmin dhe anarko-individualizmin pranë të njëjtit kulm të diamantit, duke lënë të kuptohet se ato janë të ngjashme. Në të vërtetë, liritë që ato mbrojnë janë thellësisht të papajtueshme: njëra synon lirinë kolektive nga prona private dhe hierarkia, ndërsa



tjetra lirinë individuale nga detyrimet ndaj kolektivit. Ekziston gjithashtu një ndjesi e rreme saktësie nga fakti që çdo ideologji i jepet një hapësirë me të njëjtën madhësi. Në realitet, traditat ideologjike janë të paqarta, të debatueshme dhe ndryshojnë vazhdimisht me kalimin e kohës.

Populizmi, për shembull, nga shumica e studiuesve nuk konsiderohet një ideologji më vete, por një stil politik që mund të shfaqet pothuajse në çdo pikë të hartës politike. Po ashtu, vendosja e fashizmit në skajin ekstrem të etatizmit e zhvesh atë nga tiparet që e përcaktojnë: ultranacionalizmi, hierarkia racore dhe kulti i dhunës. Kështu, një ideologji monstruoze reduktohet thjesht në një formë autoritarizmi shtetëror.

Qëndrimet ndaj emigracionit, identitetit dhe vlerave shoqërore

Atëherë, pse të mos shtohet edhe një dimension i tretë?

Pas dekadash sondazhesh ndërkombëtare, Ronald Inglehart identifikoi një bosht tjetër përgjatë të cilit ndryshojnë vlerat: nga vlerat materialiste (siguria, rendi dhe forca) drejt vlerave post-materialiste (vetëshprehja, mbrojtja e mjedisit dhe cilësia e jetës). Ky ndryshim, dhe reagimi i fortë kulturor kundër tij, ka formësuar politikën e viteve të fundit ndoshta më shumë se çdo lëvizje tradicionale mes së majtës dhe së djathtës.

Një dimension i ngjashëm është boshti GAL-TAN, i cili shkon nga Green (i Gjelbër), Alternative (Alternativ) dhe Libertarian drejt Traditional (Tradicional), Authoritarian (Autoritar) dhe Nationalist

(Nacionalist).

I zhvilluar për studimin e sistemeve partiake evropiane, ky model përfshin qëndrimet ndaj emigracionit, identitetit dhe vlerave shoqërore, çështje që modelet e mëparshme nuk arrijnë t'i pasqyrojnë plotësisht.

Por këtu lind dilema e hartografit: çdo hartë është e kufizuar nga synimet e atij që e krijon.

Çdo diagram politik i përmendur këtu tregon po aq për autorin e tij, sa edhe për realitetin politik që përpiqet të përshkruajë. Modeli i patkoit i jep rëndësi të veçantë qendrës. Nolan vendosi ideologjinë e tij të preferuar në kulmin e grafikut. Diagrami në formë diamanti tregon simpati për anarkizmin. Dhe të gjitha këto modele janë ndërtuar mbi kategori politike perëndimore. Në asnjërin prej tyre nuk ka një vend të qartë për mendimin politik konfucian, teorinë

islame të qeverisjes apo konceptin afrikan të Ubuntu. Siç thotë edhe shprehja e vjetër e hartografëve: "Harta nuk është territori."

Sa më të ndërlikuara bëhen hartat politike në përpjekje për të qenë sa më gjithëpërfshirëse, aq më shumë humbasin cilësinë që e bëri modelin fillestar kaq jetëgjatë: thjeshtësinë.

Pavarësisht kufizimeve të shumta, paradigma e ndarjes mes së majtës dhe së djathtës do të vazhdojë të përdoret edhe për shumë kohë.

Ndoshta nuk është plotësisht e saktë, por është mjaftueshëm e thjeshtë për t'u kuptuar, ashtu si një pjesë e madhe e debatit politik të ditëve tona.

Votimi që nisi gjithçka


Po si përfundoi ai votim historik që krijoi ndarjen mes të majtës dhe të djathtës?


Asambleja Kombëtare votoi me 673 vota pro dhe 325 kundër për t'i dhënë mbretit një veto pezulluese, e cila i lejonte të shtynte hyrjen në fuqi të ligjeve, por jo t'i bllokonte ato përgjithmonë.

Ishte një kompromis që nuk kënaqi askënd. Monarkistët kërkonin një mbret më të fuqishëm, ndërsa rreth 150 deputetë radikalë nuk praninin asnjë lloj vetoje mbretërore.

Gjithsesi, ky votim nuk bëri asgjë për ta afruar kurorën me popullin e uritur.

Pak javë më vonë, turmat marshuan drejt Versajës, pushtuan pallatin mbretëror dhe e dërguan mbretin dhe mbretëreshën në Paris si të burgosur, e më pas, përfundimisht, drejt gijotinës. Për atë moment, e majta kishte fituar.





QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Prishtina e nis me fitore sezonin e ri

PRISHTINË, 16 GUSHT - Skuadra e Prishtinës e ka nisur në mënyrën më të mirë sezonin 2026/27 në Superligën e Kosovës në futboll. Në ndeshjen e xhiros së parë, Prishtina e ka fituar derbin ndaj Ballkanit me rezultat 4:2. Dueli është zhvilluar të dielën mbrëma në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

Albin Krasniqi ka shënuar dy gola për Prishtinën, ndërsa nga një gol në këtë fitore kanë realizuar Assane Diatta dhe Kastriot Selmani. Për Ballkanin kanë shënuar Valentin Serebe dhe Engjëll Ajazaj. Ballkani e ka përfunduar ndeshjen me një lojtar më pak në fushë, pasi qendërmbrojtësi Ivica Batarelo është ndëshkuar me karton të

kuq në minutën e 62-të, pas ndërhyrjes ndaj Diattas. Prishtina, kështu, e ka nisur sezonin e ri me tri pikë dhe një fitore bindëse në derbin e xhiros së parë.

Edhe Malisheva e ka nisur në mënyrën më të mirë edicionin 2026/27 në Albi Mall Superligën e Kosovës, duke shënuar fitore 6:1 ndaj Vushtrrisë, derisa

Drenica dhe Dukagjini e kanë mbyllur pa gola përballjen e tyre në xhiron e parë. Po ashtu edhe skuadra e Gjiçanit e ka nisur me fitore edicionin e ri të Albi Mall Superligës së Kosovës, duke e mposhtur Feronikelin 3:1. Në kuadër të xhiros së parë, edhe kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Drita, ka fituar 5:3 përball Llapit.



PREZANTOHET EKIPI QË DO TA PËRFAQËSOJË KOSOVËN NË LOJËRAT MESDHETARE 2026

PRISHTINË, 16 GUSHT - 163 sportistë do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat Mesdhetare "Taranto 2026" në Itali. Ekipi i Kosovës është prezantuar të dielën në Prishtinë. Në Lojërat Mesdhetare "Taranto 2026" në Itali, të cilat do të zhvillohen nga 21 gushti deri më 3 shtator 2026 dhe do të mbledhin mbi 20 shtete pjesëmarrëse nga rajoni i Mesdheut. Për herë të parë, Kosova do të përfaqësohet në volejboll me të dyja kombëtare, atë të meshkujve dhe të femrave. Në ceremoninë në Prishtinë, presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, ka vlerësuar lart 163 sportistët garues. "Në Taranto, Kosova do të jetë më e madhe se kurrë më parë në Lojërat Mesdhetare. Do të jemi 163, me 87 meshkuj dhe 76 femra, të cilët do të garojnë në 21 sporte. Ky është delegacioni

më i madh i Kosovës në historinë e pjesëmarrjes sonë në ngjarjet më të mëdha sportive. Por ka edhe një tjetër shifër që meriton të theksohet këtu, sepse për herë të parë Kosova do të paraqitet me katër sporte ekipore: futboll, volejboll, hendboll dhe basketboll 3x3", është shprehur ai.

Se kjo është një mundësi e artë për Kosovën ka vlerësuar edhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti. "Pas secilës medalje, secilës fitore dhe çdo flamuri të Kosovës që është ngritur në arenat ndërkombëtare, qëndrojnë vite pune, sakrifice, disipline dhe besimi. Këto janë vlera të sporti i kultivon më së miri dhe të cilat i duhen shoqërisë sonë. Sportistët tanë kanë dëshmuar se, pavarësisht madhësisë së vendit, mund të kemi rezultate të mëdha. Në garat më të rëndësishme ndërkombëtare, ata kanë bërë



që emri i Kosovës të dëgjohet, flamuri shtetëror të valëvitet dhe himni të intonohet me krenari", ka deklaruar Kurti. Ndërsa trajneri i njohur i xhudos, Driton Kuka, i cili qëndron pas disa prej sukseseve të sportistëve kosovarë, ka theksuar se është

krenar me arritjet e Kosovës në sport. "Kosova, ndonëse e vogël, me rezultate sportive është shumë e madhe, por tash edhe me organizime sportive. Kjo është shumë e rëndësishme për ne si popull, por veçanërisht e rëndësishme për komunitetin


sportiv", është shprehur Kuka. Ndërsa fituesja e shumë medaljeve në Lojërat Olimpike, Laura Fazliu, ka deklaruar se sportistët kosovarë do të japin maksimumin në këto Lojëra Mesdhetare. "Është nder i madh për mua ta përfaqësoj Kosovën në Lojërat Mesdhetare për herë të tretë. Ne si garues, qëllimi ynë është, si çdo herë tjetër, ta ngremë flamurin e Kosovës sa më lart. Prandaj, në emër të ekipit, ju premtoj se do ta përfaqësojmë shtetin tonë të Kosovës sa më mirë që mundemi. Jemi përgatitur shumë për këto lojëra dhe besoj shumë që do të kthehemi me medalje", ka deklaruar Fazliu. Në fund të ceremonisë është bërë edhe dorëzimi i flamurit të Kosovës nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti. Ndryshe, në vitin 2030 Kosova do të jetë nikoqire e Lojërave Mesdhetare.

RONALDO: KY MUND TË JETË VITI I FUNDIT NË FUTBOLL

RIAD, 16 GUSHT - Cristiano Ronaldo ka bërë një deklaratë që ka tronditur botën e futbollit, duke pranuar se sezoni aktual mund të jetë i fundit i karrierës së tij si futbollist. Në një intervistë për "Vogue", ylli portugez 40-vjeçar ka folur hapur për të ardhmen dhe planet që ka për jetën pas futbollit.

Ronaldo ka bërë të ditur se

tashmë e ka menduar se çfarë do të bëjë pas tërheqjes, edhe pse ende nuk ka vendosur të fokusohet vetëm në një aktivitet. "Ky mund të jetë viti im i fundit në botën e futbollit dhe dua të lë një trashëgimi të madhe", ka deklaruar Ronaldo. Kapiteni i Al-Nassr ka pranuar se largimi nga futbollit do të krijonte një boshllëk të madh në jetën e tij, ndaj ka



planifikuar ta mbushë atë me aktivitete të ndryshme. "Dua të kënaqem më shumë, të udhëtoj më shumë, të shikoj dhe të luaj padel, të cilin e dua", është shprehur pesë herë fituesi i "Topit të Artë". Ronaldo gjithashtu ka kujtuar 25 vitet e karrierës së tij, të mbushura me sakrifica, stërvitje dhe gara në nivelet më të larta të futbollit. Megjithatë, deklarata e tij për

një tërheqje të mundshme e ka bërë edhe më të madhe pyetjen që tifozët kanë prej vitesh: kur do të vijë fundi i një prej karrierave më të jashtëzakonshme në historinë e futbollit? Nëse ky vërtet është sezoni i fundit, bota e futbollit mund të jetë duke parë kapitullin e fundit të një legjende që ka shënuar një epokë.

Arsenali fiton Superkupën, mposht bindshëm Cityn

LONDËR, 16 GUSHT - Arsenali e ka nisur sezonin e ri me trofe, pasi ka triumfuar në Superkupën e Anglisë, duke mposhtur bindshëm Manchester Cityn me rezultat 3:0 në "Community Shield". Ndeshja është zhvilluar

të dielën në stadiumin "Principality Stadium" në Cardiff. Arsenali e ka zhbllokuar rezultatin që në sekondat e para të takimit, me Riccardo Calafiorin, ndërsa Kai Havertz ka dyfishuar epërsinë

në pjesën e parë. Martin Odegaard e ka vulosur fitoren në fillim të pjesës së dytë. Me këtë triumf, Arsenali e ka nisur me trofe sezonin e ri, ndërsa Manchester City e ka nisur me humbje epokën e re pas

largimit të Pep Guardiols. Enzo Maresca e ka zhvilluar ndeshjen e parë zyrtare në krye të Manchester Cityt, pasardhës i Guardiols, i cili u largua nga klubi pas një dekade në drejtim.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 1283/1
Datë: 14.08.2026

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (X) në Qendrat e Kompetencës për vitin shkollor 2026/2027

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në Gjinnaze dhe IAAP, për vitin shkollor 2026/27, mund të konkurrojnë nxënësit, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.
Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkuruar për regjistrim në klasën e X-të në IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për Gjinnaze dhe IAAP për vitin shkollor 2026/2027, bëhet më datën 17, 18 dhe 19 gusht 2026 në lokalet e shkollës amë, duke filluar nga ora 9:00-16.00

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 20.08.2026
Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve.
Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkollën e dytë behën në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit për të Rritur brenda (2) dy ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

- | | | |
|---|-------|---------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) | 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) | 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) | 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100%), 100 pikë.
Kriteri i lëndëve prioritare nga suksese për gjinnaze dhe shkolla te mesme te mjekësisë është qe mesatarja e këtyre lëndëve të jetë minimum 4.00 (së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat (6-9), pastaj mesatarja e mesatareve te atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjinnaze dhe shkolla te mesme të mjeksisë është minimumi 40% e pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.
Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)} \times 2 = 40 \text{ pikë max}$$

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.
 $\text{mesatarja e lëndës (I)} + \text{mesatarja e lëndës (II)} + \text{mesatarja e lëndës (III)} + \text{mesatarja e lëndës (IV)} = 20 \text{ pikë max}$

Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP

- Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore dhe Veterinari:

Biologji, Kimi, Fizikë Gjuhe shqipe dhe letërsi,

- Makineri, Elektroteknikë, TIK. Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi — Teknologji, PTT:
Matematikë, Informatikë, Fizikë, Gjuhë Shqipe dhe letërsi

- Ekonomi, Administratë:**

Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi

- Juridik dhe Administratë:**

Gjuhe shqipe dhe letërsi, Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi

- Tregti, Hotelieri dhe Turizëm:**

Gjuhë shqipe dhe letërsi Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi

- Shkollat Artistike:**

Gjuhë amtare dhe letërsi Edukat qytetare, Art, Muzikë

- Drejtimi pedagogjik - profili bashkëpunëtor muzikor:**

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar;

- Drejtimi instrumental:**

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII); në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI).

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë, duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

2. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- Shkollat e Shëndetësisë** – Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji)

$$\frac{\text{mes(Kimi)} + \text{mes(Biologji)} + \text{mes(Fizikë)} + \text{mes(Gjuhë_shqipe)}}{4} \geq 4$$

- Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në IAAP

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

- | | |
|--|---------------------|
| 1. Shkencat natyrore - 25 | 25 x 0.8 = 20 pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 25 | 25 x 0.4 = 10 pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë - 25 | 25 x 0.3 = 7.5 pikë |
| 4. Shkencat shoqërore - 25 | 25 x 0.1 = 2.5 pikë |
| Totali | = 40 pikë |

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji

- | | |
|--|---------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë - 25 | 25 x 0.8 = 20 pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 25 | 25 x 0.4 = 10 pikë |
| 3. Shkenca natyrore - 25 | 25 x 0.3 = 7.5 pikë |
| 4. Shkenca shoqërore - 25 | 25 x 0.1 = 2.5 pikë |
| Totali | = 40 pikë |

III. Ekonomi

- | | |
|--|---------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë - 25 | 25 x 0.8 = 20 pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 25 | 25 x 0.4 = 10 pikë |
| 3. Shkenca shoqërore - 25 | 25 x 0.3 = 7.5 pikë |
| 4. Shkencat natyrore - 25 | 25 x 0.1 = 2.5 pikë |
| Totali | = 40 pikë |

IV. Juridik

- | | |
|--|---------------------|
| 1. Shkencat shoqërore - 25 | 25 x 0.8 = 20 pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 25 | 25 x 0.4 = 10 pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë - 25 | 25 x 0.3 = 7.5 pikë |
| 4. Shkenca natyrore - 25 | 25 x 0.1 = 2.5 pikë |
| Totali | = 40 pikë |

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

- | | |
|--|---------------------|
| 1. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 25 | 25 x 0.8 = 20 pikë |
| 2. Shkenca shoqërore - 25 | 25 x 0.4 = 10 pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë - 25 | 25 x 0.3 = 7.5 pikë |

4. Shkenca natyrore - 25

25 x 0.1 = 2.5 pikë

Totali = 40 pikë

- VI. Shkollat Artistike
1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 25

25 x 0.8 = 20 pikë
2. Shkenca shoqërore - 25

25 x 0.4 = 10 pikë
3. Matematikë dhe Informatikë - 25

25 x 0.3 = 7.5 pikë
4. Shkenca natyrore - 25

25 x 0.1 = 2.5 pikë
- Totali = 40 pikë

KONKURSI PËR QENDRAT E KOMPETENCËS AFATI I GUSHTIT 2026/27

Vendi	Shkolla	Drejtimi/Fusha	Profili	Nr. paraleleve	Nr. i vendeve të lira
Prishtinë	"Shtjefën Gjeçovi"	Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Dirigjimi kompjuterik i makinave	1	07
			Metalpunues-DUAL	1	13
			Mekatronikë	1	06
			Trafik Rrugor	1	13
			Transport Rrugor	1	14
		Arte	Konfeksion	1	11
			Rrobaqepësi	1	02
			Gjithsej: "Sh. Gjeçovi"		
				7	66

Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nxën.
Qendra e kompetencës "Kujtim Krasniqi"	ADMINISTRATE-EKONOMI	Nëpunës i Administratës dhe Shërbimeve të Zyrës	0	10
		Nëpunës për Banka, Financa dhe Sigurime	0	14
		Nëpunës i Marketingut dhe Shitjes	1	15
		Tregtar me pakicë dhe shumicë- DUAL	0	19
		Kuzhinier - DUAL	0	13
	ELEKTROTEKNIK MAKINERI	Teknik i sistemeve te TIK-ut	0	0
		Instalues elektrik	0	7
		Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	0	0
	ART	Dizajn tekstil dhe veshje	0	5
		Totali	0	83

Ferizaj	Qendra e Kompetencës	Shëndetësi	Bashkëpunëtor profesional i infermierisë	0	0
			Asistent i fizioterapisë	1	14
			Teknik i laboratorit mjekësor	0	0
			Teknik dentar	0	0
			Teknik i farmacisë	0	0
			Teknik i optikës	1	11
			Asistent i sigurisë ushqimore dhe dietave	1	23
			Gjithsej: QK	3	48
Skenderaj	Qendra e Kompetencës"	Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Ngjyrë punues, Ilak punues	1	5
			Konstruksione të thata		6
			Llamarinë punues dhe punues metali		7
			Zdrukthtëtar me punë kulmi	1	8
			Muratorë dhe punëtorë të ngjashëm (Dual)	1	14
		Shërbime	Kuzhinier (Dual)	1	12
			Asistent i mikëpritjes hoteliere (Dual)	1	9
			Gjithsej: Qendra e Kompetencës	5	61

Prizren	"11 Marsi"	Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Telekomunikacion	1	7
			Informatikë	1	5
			Dizajn softueri	1	10
			Teknik i sistemeve të TIK-ut	1	5
		Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Instalues elektrik-DUAL		
				1	5
			Mekatronikë	1	12
			Trafik rrugorë	1	9
			Automekanik-DUAL	1	3
			Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	1	24
			Metalpunues-DUAL	1	22
			Ndërtimtari	1	16
		Art	Dizajn grafik	1	12
			Dizajn tekstil dhe veshje	1	15
			Gjithsej: "11 Marsi" (shq.)	13	145
			Mësimi në gjuhën boshnjake		
		Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Automekanik		
				1	13
			Instalues elektrik		
		Teknologji e informacionit dhe komunikimit		1	8
			Dizajn tekstil dhe veshje	1	21
		Art	Gjithsej: Gj. boshnjake	3	42
			Mësimi në gjuhën turke		
		Art	Mekatronikë	1	14
			Gjithsej: Gj. turke	1	
			Gjithsej: "11 Marsi"	17	201

Qendra e Kompetencës në Prizren	Ekonomi, administrim dhe juridik	Financa		
			1	24
		Marketing	1	24
	Shërbime	Tregti me pakicë dhe shumicë-DUAL	1	24
		Udhëheqës i udhëtimeve dhe grupeve turistike	1	24
		Esteticient-DUAL	1	24
		Asistent i mikpritjes hoteliere-DUAL	1	24
		Floktari-DUAL	1	24
		Asistent në organizimin e ngjarjeve	1	24
		Teknologji e informacionit dhe komunikimit	1	24
		Gjithsej: Qendra e Kompetencës	9	216



Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke u bazuar në nenin 110 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 20 dhe nenin 21 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenin 24 të Ligjit 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, nenin 12 dhe nenin 13 të Rregullores Nr. 02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, si dhe Vendimin KPK/Nr. 481/2026 të datës 04 gusht 2026, shpall:

PËR REKRUTIMIN E TRIDHJETEKATËR (34) KANDIDATËVE PËR PROKUROR TË SHTETIT NË PROKURORITË THEMELORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PREJ TYRE DHJETË (10) POZITA JANË TË REZERVUARA PËR KOMUNITETIN SERB

Kompetencat dhe përgjegjësitë e prokurorëve të shtetit përfshijnë:

1. Ushttrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
2. Zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;
3. Sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale dhe bazuar në legjisllacionin në fuqi dhe kodin e etikës profesionale;
4. Ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të Prokurorit të Shtetit;
5. Mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve dhe të pandehurve;
6. Ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale;
7. Marrjen e vendimeve për iniciimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale;
8. Ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës;
9. Ushttrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore;
10. Bashkëpunimin me policinë, gjykatat dhe institucione e tjera;
11. Ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 24 i Ligjit Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit parasheh kushtet e përgjithshme:

- 24.1. Kandidati për emërim për Prokuror të Shtetit, duhet t'i plotësojë këto kushte:
1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 2. të ketë diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshëm në Kosovë;
 3. të ketë kryer provimin e Jurisprudencës, të pranuar sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë;
 4. të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal;
 5. të mos jetë i dënuar për veprë penale, përveç veprave penale të kryera nga pakujdesia;
 6. të ketë së paku tri (3) vjet përvojë pune profesionale në fushën juridike, pas diplomimit;
 7. të ketë kaluar provimin për prokuror, në pajtim me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli;
 8. të mos ketë aktakuzë të ngritur, përjashtimisht atyre të ngritura për vepra penale të kryera nga pakujdesia.
- 24.2. Për qëllime të këtij neni, përvoja në fushën juridike përfshin përvojën në çështje juridike në institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, përvojën si noter dhe përmbarues privat.

Në pajtim me nenin 13 të Rregullores Nr. 02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, kandidati duhet të dorëzojë/bashkëngjisë dokumentet si më poshtë:

1. Aplikacionin e plotësuar me të dhënat e kërkuara;
2. Certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
3. Diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshme në Republikën e Kosovës;
4. Certifikatën e provimit të Jurisprudencës të pranuar sipas Ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës;
5. Certifikatën nga evidenca penale lëshuar nga gjykata;
6. Dëshminë për përvojën e punës në fushën juridike;
7. Informatat e siguruar nga punëdhënësi për së paku tre (3) vjet të përvojës profesionale në fushën juridike, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në përshkrimin e detyrave të punës, performancën profesionale, masat disiplinore dhe çështjet e tjera që konsiderohen relevante për procesin, të shoqëruara edhe me dokumente mbështetëse për vlerësimin e integritetit personal dhe aftësive profesionale, siç parashihen me këtë rregullore dhe dispozitat e ligjeve të aplikueshme;
8. Kandidati mund të dorëzojë edhe publikime profesionale apo akademike dhe informata për pjesëmarrje në trajnime.

Kandidatët mund të aplikojnë në formë fizike, përmes postës së rregullt, postës elektronike (e-mail), si dhe online (aplikacioni elektronik).

Kandidatët mund të aplikojnë në formë fizike ose përmes postës së rregullt, duke shkarkuar dhe duke plotësuar formularin e aplikimit nga faqja zyrtare <https://prokuroria-rks.org/>. Formulari i aplikimit (aplikacioni) së bashku me dokumentet mbështetëse të përcaktuara me konkurs dorëzohet në Divizionin për Verifikim Prokurorial, në adresën Rr. "Luan Haradinaj", objekti i Prokurorisë të Shtetit, Prishtinë.

Kandidatët të cilët aplikojnë në formë elektronike (email), formularin e aplikimit (aplikacionin) dhe dokumentet e përcaktuara me konkurs, të skanuara mund t'i dërgojnë në adresën aplikimi.prokuror@rks-psh.org

Ndërsa, kandidatët të cilët aplikojnë përmes aplikacionit elektronik (online) mund të qasen përmes vegëzës së veçantë, e cila do të vendoset në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës ose drejtpërdrejt në vegëzën si në vijim:

<https://aplikimi.prokuroria-rks.org/>

Për informacione për mënyrën e regjistrimit dhe aplikimin online, ju mund të shkarkoni **VIDEON** nga platforma online.

1. Neni 13, paragrafi 6 i Rregullores Nr.02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, përcakton se procesit të rekrutimit kanë të drejtë t'i nënshtrohen vetëm kandidatët e regjistruar në Këshill, në afatin e paraparë në konkurs për aplikim dhe dokumentacion të kompletuar. Ndërsa, kandidatët të cilët nuk kanë aplikuar brenda afatit të paraparë me konkurs, si dhe ata të cilët kanë aplikuar në afat, por nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar sipas kriterëve dhe kërkesave të konkursit, nuk do të merren parasysh.

3. Afati për dorëzimin e aplikacionit është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi i konkursit, gjegjësisht nga data 17.08.2026 deri më 31.08.2026.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime
drejtë përqaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook 

www.facebook.com/gjeipuneshpejter

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council



Tužilački Savet Kosova, na osnovu člana 110 stav 2 Ustava Republike Kosova, člana 7 stav 1 podstav 1.6, člana 20 i člana 21 Zakona Br.06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, člana 24 Zakona Br. 08/L-167 o Državnom Tužiocu, člana 12 i člana 13 Pravilnika Br.02/2022 o Rekrutovanju, Ispitu, Imenovanju i Ponovnom Imenovanju Državnih Tužilaca, kao i Odluke TSK/Br. 481/2026 datuma 04 avgust 2026, objavljuje:

JAVNI KONKURS

ZA REGRUTOVANJE TRIDESET ČETIRI (34) KANDIDATA ZA DRŽAVNE TUŽIOCE U OSNOVNIM TUŽILAŠTVIMA REPUBLIKE KOSOVA, OD KOJIH DESET (10) POZICIJA SU REZERVISANA ZA SRPSKU ZAJEDNICU

NADLEŽNOSTI I ODGOVORNOSTI DRŽAVNIH TUŽILACA

Nadležnosti i odgovornosti državnih tužilaca obuhvataju:

1. Nezavisno, pošteno, objektivno i nepristrasno obavljati tužilačke funkcije i osigurati da se sva lica tretiraju jednako pred zakonom;
2. Sprovođenje najviših standarda brige prilikom obavljanja službenih funkcija;
3. Pošteno i profesionalno ponašanje kako u ličnom, tako i profesionalnom životu u skladu sa važećim zakonima i kodeksom profesionalne etike;
4. Očuvanje časti i dostojanstva Državnog Tužioca;
5. Zaštita zakonskih prava žrtava, svedoka i optuženih;
6. Preduzimanje potrebnih zakonskih radnji na otkrivanju krivičnih dela i identifikaciji počinilaca, kao i blagovremenoj istrazi i procesiranju krivičnih dela;
7. Donošenje odluka o pokretanju, nastavku ili prekidu krivičnog postupka protiv lica osumnjičenih ili optuženih za izvršenje krivičnih dela;
8. Podizanje optužnica i zastupanje pred sudom;
9. Primena redovnih i vanrednih pravnih lekova protiv sudskih odluka;
10. Saradnja sa policijom, sudovima i drugim institucijama;
11. Preduzimanje svih drugih radnji utvrđenih zakonom.

TRAŽENI ZAKONSKI KRITERIJUMI

Član 24. Zakona Br. 08/L-167 o Državnom Tužiocu predviđa opšte uslove:

24.1. Kandidat za imenovanje za Državnog Tužioca mora da ispunjava ove uslove:

1. da je državljanin Republike Kosova;
2. da ima diplomu pravnog fakulteta koja je važeća na Kosovu;
3. da ima položen pravosudni ispit, priznat prema važećem zakonu na Kosovu;
4. da ima visok profesionalni ugled i lični integritet;
5. da nije kažnjavao / a za krivično delo, osim krivičnih dela počinjenih iz nehata;
6. da ima najmanje tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u pravnoj oblasti nakon diplomiranja;
7. da ima položen ispit za tužioce u skladu sa uslovima i postupkom utvrđenim posebnim pravilnikom usvojenim od strane Saveta;
8. da nema podignutu optužnicu, osim onih podignutih za krivična dela počinjenih iz nehata.

24.2. Za potrebe ovog člana, iskustvo u pravnoj oblasti obuhvata iskustvo u pravnim poslovima u domaćim i međunarodnim institucijama, iskustvo kao notar i privatni izvršilac.

POTREBNI DOKUMENTI

U skladu sa članom 13. Pravilnika 02/2022 o Rekrutovanju, Ispitu, Imenovanju i Ponovnom Imenovanju Državnih Tužilaca, kandidat mora dostaviti/priložiti sledeća dokumenta:

1. Aplikaciju popunjenu sa potrebnim podacima;
2. Uverenje o državljanstvu Republike Kosova;
3. Diplomu Pravnog Fakulteta koja je važeća na Kosovu;
4. Uverenje o Pravosudnom Ispitu priznatu u skladu sa važećim zakonom u Republici Kosova;
5. Uverenje iz krivične evidencije izdato od suda i
6. Dokaz o radnom iskustvu u pravnoj oblasti;
7. Informacije od poslodavca o najmanje tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva, koje uključuju, ali se ne ograničavaju u opisu radnih obaveza, profesionalnom učinku, disciplinskim merama i drugim pitanjima koja se smatraju relevantnim za proces, uz prateću dokumentaciju za procenu ličnog integriteta i profesionalnih sposobnosti, kako je predviđeno ovim pravilnikom i odredbama važećih zakona.
8. Kandidat može dostaviti i stručne i akademske publikacije i informacije o učešću na obuci.

NAČIN APLIKACIJE

Kandidati mogu aplicirati u fizičkom obliku ili redovnom poštom, elektronskom poštom (e-mail) kao i online aplikacija (elektronska aplikacija).

Kandidati mogu aplicirati lično ili redovnom poštom, preuzimanjem i popunjavanjem formular aplikacije sa službenog sajta <https://prokuroria-rks.org/> Obrazac aplikacije (aplikacija) zajedno sa pratećom dokumentacijom navedenom u konkursu podnosi se Kancelariji za Tužilačku Verifikaciju, na adresi Ul. Luan Haradinaja, zgrada Državnog Tužioca, Priština.

NAČIN APLIKACIJE

Kandidati mogu aplicirati u fizičkom obliku ili redovnom poštom, elektronskom poštom (e-mail) kao i online aplikacija (elektronska aplikacija).

Kandidati mogu aplicirati lično ili redovnom poštom, preuzimanjem i popunjavanjem formular aplikacije sa službenog sajta <https://prokuroria-rks.org/> Obrazac aplikacije (aplikacija) zajedno sa pratećom dokumentacijom navedenom u konkursu podnosi se Kancelariji za Tužilačku Verifikaciju, na adresi Ul. Luan Haradinaja, zgrada Državnog Tužioca, Priština.

Kandidati koji apliciraju elektronskim putem (e-mail), formular aplikacije (aplikacija) i dokumente navedene u konkursu, mogu skenirane poslati na adresu aplikimi.prokuror@rks-psh.org

Dok, kandidati koji apliciraju putem elektronske aplikacije (online) mogu pristupi putem posebnog linka koji će biti postavljen na službenoj stranici Tužilačkog Saveta Kosova ili direktno na sledećem linku:

<https://aplikimi.prokuroria-rks.org/>

Za informacije o tome kako da se registrujete i aplicirate online, možete preuzeti VIDEO sa online platforme.

VAŽNO OBAVEŠTENJE ZA KANDIDATE

1. Član 13. stav 6. Pravilnika Br. 02/2022 o Rekrutovanju, Ispitu, Imenovanju i Ponovnom Imenovanju Državnih Tužilaca, propisano je da se procesu regrutovanja mogu podvrgnuti samo kandidati registrovani u Savetu, u roku predviđenom konkursom za aplikaciju i sa kompletnom dokumentacijom. Dok, kandidati koji nisu aplicirali u roku predviđenim konkursom, kao i oni koji su aplicirali u roku, a nisu dostavili kompletnu dokumentaciju prema kriterijumima i uslovima konkursa, neće biti uzeti u obzir.

2. Ohrabruju se svi kandidati iz nevećinskih zajednica da apliciraju za ove pozicije.

3. Rok podnošenja aplikacije je petnaest (15) dana od objavljivanja konkursa, odnosno od 17.08.2026 do 31.08.2026.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992





ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908